

Regjisori francez Eric Vigner, i pranishëm në premierë

Më në fund, çdo kalimtar i që shkon në qendër të Tiranës do t'i bier në sy një kalendar në formën e një posteri të madh ku janë shkruar të gjitha datat e shfaqjeve që do të jepen gjatë gjithë këtij sezoni artistik. Kjo dukuri është pa dyshim një nga arritjet më të mira të Teatrit Kombëtar në gjithë këto vitet e fundit, arritje që është përmbushur edhe me ngjytjen e premierave të sukseshme në skenë, të cilat riciklohen herë pas here për auditore të ndryshme. Pas shfaqjes më suksese të dramës shqipe "Korbi i bardhë" me regji të Mihal Luarasit, premiera botërore, "Berberi i Seviljes", do të shfaqet këtë fundjavë nga data 20, 21, 22 prill në skenën e Teatrit Kombëtar në Tiranë. Stafi që mori përsipër vënien në skenë të kësaj komedie, të shkruar nga francezi i mirënjohur Beaumarchais ka njoftuar për premierën dhe në një konferencë për shtyp. Drama në fjalë është përkthyer nga Klio Evangjeli dhe vënë në skenë nga regjisori francez Eric Vigner, i pranishëm në këtë prezantim. Regjisori francez Vigner ka bërë të ditur për median të dhënat historike, teknike dhe artistike të kësaj vepre, të cilësuar si "një ngjarje në kulturën

shqiptare". Ndërkohë ai ka kujtuar faktin se komedia e shkruar para Revolucionit Francez i vitit 1773, gjithnjë është cilësuar si vepër me strukturë moderne dhe ka shënuar kalimin nga teatri klasik francez në atë modern. Drejtori i Teatrit Kombëtar, Kristaq Skami, u shpreh se komedia është realizuar nga një kast aktorësh të njohur të Teatrit Kombëtar, si Luiza Xhuvani në rolin e Rozinës, Roland Trebicka në rolin e Kontit Almaviva, Marko Bitraku në rolin e Don Bazilios, Helidon Fino në rolin e Figaros, Neritan Liçaj në rolin e Bartolos, etj. Ideja kryesore e kësaj vepre është himnizimi dhe sakrificat që duhet të bëjë njeriu për të fituar dhe triumfuar në emër të

dashurisë. Skrami ka përsëndetur me këtë rast edhe mbështjetjen e ambasadës franceze në Tiranë, e cila ndihmoi me vullnetin e saj realizimin e kësaj shfaqje që kërkon një suport të madh teknik.

Një dramë-spektakël

Në qendër të veprës është një grua, të cilën i shoqi me xhelozinë e tij dhe ndjenjën e inferioritetit që ka ndaj saj, e ka burgosur dhe e mban të fshehur nga sytë e botës. Kjo është arsyeja që autori, Rozinën edhe Figaron, si edhe ambientet e shtëpisë së tyre i ka trajtuar të gjitha të mbuluara me ngjyrën e zezë. Ndërsa në të kundërt, Almavivën, e cila simbolizon dashurinë si dhe Figaron, që në një lloj

mënyre është dirigjenti i strategjisë për t'u futur në këtë burg të zi dhe që aty të rrëmbejnë Rozinën, janë veshur në të bardha. Vizioni modern, elegant i kohës është sjellë për publikun shqiptar me kostume të frymëzuara nga fotografi i shquar shqiptar, Marubi, dhe ato vijnë në këtë spektakël si një kontrast bardh e zi në përputhje me idenë e regjisorit mbi këtë vepër. Personazhet prezantohen në këtë dramë me veshjet tradicionale qytetare të veriut të Shqipërisë, ndërthurur me fustanellën e jugut, realizuar nga stilistja e njohur Anila Zajmi. Dekori i shfaqjes "Berberi i Seviljes" është realizuar me ndriçim dhe efekte speciale, koncept ky i cili, sipas regjisorit të

shfaqjes, zërthen përmes efekteve të dritave, idenë e tij për luftën mes dritës dhe errësirës. Siç u njoftua në këtë konferencë, kjo do të bëhet e mundur nga paisje shtesë për ndriçim e fonisë që do të vinë nga Franca, si dhe nga zbatimi i skemës regjisoriale nga një inxhinier francez. Realizimi teknik i kësaj vepre, e cila është mbështetur në një ndriçim special, e cila evidenton në mënyrë simbolike një dantellë gjigande sa e gjithë hapësira e skenës. Dekori është ideuar nga i regjisori i shfaqjes, i cili përpos profesionit të regjisorit, ka edhe atë të piktorit. Ndërsa muzika është kompozuar enkas për këtë komedi nga kompozitori dhe muzikanti i mirënjohur Fatos Qerimi.

Eric Vigner në botën e teatrit

Eric Vigner, aktualisht drejtor i teatrit rajonal të qytetit Lorient (France), e ka konsideruar një eksperiencë të vyer bashkëpunimin me aktorët shqiptarë. Si një regjisor, i cili ka në repertorin e tij drama të sukseshme të repertorit aktual francez, tek ai veçohet bashkëpunimi me Margerit Duras, "Shiu i verës", që fillimisht u ngjit në skenën e

Konservatorit Kombëtar të Artit Dramatik, Paris, për të patur me pas një tur të suksesshëm jo vetëm në Francë, por edhe në Rusi. Ndërsa në 2002, kur vepra e shkrimtarës hyri në repertorin e Comedie Francais, Vigner u thirr nga teatri Kombëtar francez për të vënë sërish në skenë një nga veprat e saj. Në 2000 Eric Vigner është regjisor i Rinoceront të Joneskos, vënë në skenë e teatrit të Lorient. Eric Vigner kohë pas kohe i është rikthyer suksesshëm repertorit klasik të komedisë frënge, duke arritur të ngjitet në skenën e Teatrit Kombëtar francez (Comedie Francais) me vepra të Rasinit (1996), të Molerit (1999). Në vitin 2004 ai vuri në skenë "Borgjezi fisnik" në teatrin Kombëtar të Koresë. Menjëherë pas premierës në Seul trupa koreane bëri një turne në Francë. Gjithashtu kjo trupë ka dhënë shfaqje në 2006 për tre javë në Operan Komike, Paris. Viti 2000 shënoi eksperiencën e parë të Eric Vigner në opera, duke ngjitur në skenën e Lozanës operan "Didone" të Cavalli-t, ndërsa eksperiencia e dytë ishte në vitin 2003 kur u ftua nga Festivali "Bach" i Lajpcigut (Gjermani)

